



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Seancë plenare e Kuvendit

P- 012

Prishtinë, më 28 mars 2008, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
28 MARS 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Nexhat Daci**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 93 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se, në bazë të rregullave 6. 2 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 12, 13 dhe 14 marsit 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit të produkteve për mbrojtjen e bimëve, dhe
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 12, 13 dhe 14 marsit 2008

Procesverbalet e seancave plenare të 12, 13 dhe 14 marsit 2008 u miratuan pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Sanije Aliaj** i parashtroi pyetje ministrit të Transportit dhe Post-Telekomunikacionit lidhur me gjendjen në vendkalimet e hekurudhës Reçak – Ferizaj.

Ministri **Fatmir Limaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Sanije Aliaj**.

Deputeti **Hajredin Hyseni** i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me projektet e kësaj ministrie për mbrojtjen e Liqenit të Batllavës nga ujërat e zeza.

Ministri **Mahir Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputetit Hajredin Hyseni.

Pyetjet e deputetëve Driton Tali dhe Bahri Hyseni, që i kishin parashtruar për Kryeministrin Hashim Thaçi, u shtynë për seancën tjetër, ngase Kryeministri nuk ishte i pranishëm në seancë.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit të produkteve për mbrojtjen e bimëve

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta paraqesë Projektligjin e produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, **Idriz Vehapi**, tha se qëllimi i këtij projektligji është krijimi i bazës ligjore për parimet e përgjithshme, që kanë të bëjnë me vendosjen në treg dhe kontrollimin e substancave aktive të produkteve për mbrojtjen e bimëve, autorizimin, qarkullimin, përdorimin, mbajtjen e regjistrit dhe regjistrin e personave fizikë dhe juridikë.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është e një rëndësie të veçantë, sepse Kosovës i mungon legjislacioni i përshtatshëm, i cili i referohet vendosjes në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Struktura e këtij projektligji është radhitur në dhjetë kapituj dhe 59 nene.

Në kapitullin e parë janë përfshirë dispozitat e përgjithshme; Në kapitullin e dytë janë përfshirë dispozitat, që rregullojnë vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve; Në kapitullin e tretë janë përfshirë dispozita që rregullojnë procedurat e autorizimit; Në kapitullin e katërt janë përfshirë dispozitat që rregullojnë autorizimet; Në kapitullin e pestë janë përfshirë dispozitat, me të cilat rregullohet regjistri i produkteve për mbrojtjen e bimëve; Në kapitullin e gjashtë rregullohen shërbimet profesionale; Në kapitullin e shtatë rregullohet importi i produkteve për mbrojtjen e bimëve; Në kapitullin tetë rregullohen autorizimet dhe detyrat e autoritetit përgjegjës; Në kapitullin nëntë janë dispozitat ndëshkimore, dhe në kapitullin e fundit janë dispozitat përfundimtare.

Në fund të prezantimit, ministri **Vehapi** i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratojnë Projektligjin e produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Pas prezantimit të projektligjit, **Kryetari** hapi debatin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për Projektligjin e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Elheme Hetemi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Myrvete Pantina**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Heset Cakolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Sadik Idriz**, dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Bojan Stojanović**, të cilat janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, **Kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----78,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin e produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislacion dhe Gjqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.

Ministri për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, **Mahir Yagcilar**, tha se qëllimi i këtij projektligji është arritja e parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes, e cila vjen si pasojë e veprimtarive në industrinë energjetike, prodhimin dhe përpunimin e metaleve, industrinë e mineraleve, industrinë kimike, menaxhimin e mbeturinave, aktivitetet minerare dhe aktivitetet e tjera.

Arsye për nxjerrjen e këtij projektligji është se me legjislacionin në fuqi në Kosovë, kjo fushë nuk ka qenë e rregulluar. Ky projektligj rregullon këtë fushë sipas rregullave të përcaktuara nga Bashkimi Evropian.

Me këtë projektligj kontrollohet dhe parandalohet ndotja e integruar e mjedisit. Operatorët, për të zhvilluar veprimtarinë e tyre në pajisjet e caktuara, janë të detyruar të nxjerrin leje nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Nxjerrja e lejes mundëson punën me pajisjeve të reja, afatizon punën me pajisjet ekzistuese, jo më shumë se 10 vjet.

Harmonizimi i legjislationit të Kosovës me Direktivën e Bashkimit Evropian për IPPC kërkon një përfshirje të gjithmbarshme të detyrimeve të cilat Direktiva i shtron për shtetet anëtare në Bashkimin Evropian, si dhe për shtetet që pretendojnë anëtarësimin në BE.

Struktura e Projektligjit është e radhitur në pesë kapituj, në 23 nene dhe në katër anekse.

Për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete buxhetore shtesë.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Selvije Halimi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Njomëza Emini**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Enis Kervan**, dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Bojan Stojanović**, si dhe deputetët: **Hydajet Hyseni** dhe **Riza Smaka**, të cilat janë dhënë në transkript.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 85,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor – si komision funksional dhe raportues, si dhe Komisionin për Legjislation dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa dhe Komisionin për Komunitete që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale